Ftesë për trajnim

MENAXHIMI I DIGJITALIZUAR I FINANCAVE PUBLIKE: LEGJISLACIONI, STANDARDET, SISTEMET DHE PRAKTIKAT E AVANCUARA

Trajnimi mbahet në Durrës nga data 13 - 16 nëntor 2026

Trajnimi është i dedikuar për Zyrtarët Kryesorë Financiar, Zyrtarët Financiar, Auditor të organizatave buxhetore të nivelit qendror dhe lokal udhëheqësve dhe zyrtarëve të burimeve njerëzore, zyrtarëve përgjegjës për paga dhe të gjithë ata që dëshirojnë ti rrisin njohuritë e tyre në temën e cekur. Ka për qëllim të forcojë kapacitetet e tyre në menaxhimin e financave publike, në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikat më të mira të menaxhimit të financave publike.
Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të thellojnë njohuritë e tyre përmes ligjëratës dhe punës praktike dhe elaborimit të secilit komponent kyç në kuadër te moduleve te përzgjedhura ne këtë trajnim.

Trajnimi do te organizohet ne këto module:

1. Kuadri ligjor për menaxhimin e financave publike

- Arkitektura e legjislacionit për menaxhimin e financave publike.
- Legjislacioni bazë për buxhetin, Thesarin, pasurinë publike, borxhin dhe prokurimin publik.
- Përgjegjësitë institucionale dhe linjat e llogaridhënies.
- Ndarja e detyrave, delegimi i autorizimeve dhe dokumentimi i vendimmarrjes financiare.

2. Proceset dhe procedurat në sistemin e menaxhimit të financave publike

- Cikli vjetor i buxhetit dhe proceset e ekzekutimit.
- Procedurat e Thesarit për zotimet, obligimet, certifikimin dhe pagesat.
- Kontrollet paraprake dhe dokumentacioni mbështetës i shpenzimeve.
- Harmonizimi i procedurave me Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK).
- Identifikimi dhe trajtimi i mospërputhjeve gjatë procedimit të shpenzimeve.

3. Digjitalizimi i procesit të pagesave dhe integrimi i sistemeve

Faturimi elektronik dhe gjurmimi i faturave

- Regjistrimi, dorëzimi, pranimi dhe gjurmimi elektronik i faturave.
- Dallimi ndërmjet faturimit elektronik dhe sistemeve për evidentimin e gjurmimin e faturave.
- Kërkesat ligjore, standardet përkatëse dhe zhvillimet në zbatimin e tyre.

Digjitalizimi i procesit të pagesave në Thesar

- Rrugëtimi elektronik i dokumentacionit financiar.
- Kontrollet elektronike dhe mundësitë e automatizimit të proceseve.
- Autorizimet, gjurmueshmëria e veprimeve dhe ruajtja e dokumentacionit.

Ndërlidhja e sistemeve të prokurimit publik me Thesarin

- Ndërlidhja e e-Prokurimit me SIMFK, sipas funksionaliteteve në përdorim dhe zhvillimeve përkatëse.
- Shkëmbimi i të dhënave për kontratat, zotimet, obligimet dhe pagesat.
- Kontrollet për përputhjen e të dhënave ndërmjet sistemeve.

Administrimi digjital i të dhënave të furnitorëve

- Regjistrimi dhe përditësimi i të dhënave të operatorëve ekonomikë.
- Verifikimi, validimi dhe mirëmbajtja e të dhënave.
- Ndërveprueshmëria me sistemet e prokurimit dhe të Thesarit, sipas mundësive teknike dhe rregullave të zbatueshme.

Transparenca dhe publikimi i të dhënave financiare

- Platformat dhe mekanizmat për publikimin e të dhënave financiare.
- Transparenca e buxheteve, kontratave dhe pagesave.
- Saktësia dhe përditësimi i të dhënave të publikuara.
- Kufijtë ligjorë të publikimit dhe mbrojtja e të dhënave personale.

4. Menaxhimi i aseteve publike

- Regjistrimi dhe kategorizimi i aseteve.
- Inventarizimi dhe rakordimi i gjendjes fizike me regjistrat.
- Zhvlerësimi dhe raportimi sipas rregullave të zbatueshme.
- Dokumentimi i pranimit, transferimit dhe largimit të aseteve nga përdorimi.
- Ndërlidhja dhe rakordimi i regjistrave të aseteve me të dhënat në SIMFK.

5. Menaxhimi i projekteve publike

- Cikli i jetës së projektit publik.
- Planifikimi dhe menaxhimi financiar i projekteve.
- Monitorimi i shpenzimeve dhe raportimi.
- Analiza e rrezikut dhe koordinimi me donatorët.
- Dokumentacioni mbështetës për kontrollin dhe auditimin e projekteve.

6. Standardet e kontabilitetit dhe raportimit financiar

- Kuadri i zbatueshëm i kontabilitetit dhe raportimit financiar në organizatat buxhetore.
- Standardi IPSAS sipas bazës së parasë së gatshme dhe dallimet nga standardet sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.
- Përgatitja dhe konsolidimi i pasqyrave financiare.
- Rakordimet dhe shpalosjet në raportimin financiar.
- Raportimi jofinanciar dhe zhvillimet ndërkombëtare në raportimin e qëndrueshmërisë.

7. Praktikat e mira në menaxhimin e financave publike

- Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm.
- Identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve.
- Transparenca fiskale dhe raportimi i bazuar në analiza.
- Monitorimi i kontrolleve dhe përmirësimi i procedurave financiare.

8. Ndërlidhja e proceseve financiare me burimet njerëzore

- Planifikimi i shpenzimeve për paga dhe kompensime në ndërlidhje me planin e personelit dhe mjetet buxhetore të aprovuara.
- Dokumentacioni i burimeve njerëzore si bazë për përfshirjen dhe ndryshimet në listëpagesë.
- Efektet financiare të vendimeve për personelin dhe procedimi i tyre për pagesë, sipas legjislacionit të zbatueshëm.
- Rakordimi i të dhënave të personelit me listëpagesat, pagesat e ekzekutuara dhe regjistrimet financiare.
- Ndarja e detyrave ndërmjet burimeve njerëzore dhe financave gjatë përgatitjes, verifikimit dhe procedimit të pagesave.
- Qasja e autorizuar dhe mbrojtja e të dhënave personale gjatë përpunimit të dokumentacionit për paga.

9. Kontrolli dhe auditimi i proceseve financiare të digjitalizuara

- Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve në shpenzimet publike, përfshirë pagat dhe kompensimet.
- Vlerësimi nga auditimi i brendshëm i funksionimit të kontrolleve financiare, duke respektuar pavarësinë e tij nga përgjegjësitë operative.
- Dokumentacioni elektronik dhe gjurma e auditimit për verifikimin e autorizimeve, ndryshimeve dhe pagesave.
- Përdorimi i të dhënave elektronike për identifikimin e pagesave të dyfishta, mospërputhjeve dhe ndryshimeve të pambështetura me dokumentacion.
- Përgjegjësitë e njësive përkatëse për adresimin e gjetjeve të auditimit.
- Përgatitja e planeve të veprimit dhe monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimit.
- Raste praktike që ndërlidhin financat, burimet njerëzore dhe auditimin me ligjshmërinë, saktësinë dhe gjurmueshmërinë e shpenzimeve publike.

REZULTATET E PRITSHME PËR PJESËMARRËSIT

Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit pritet të zhvillojnë:

- Njohuri të avancuara për menaxhimin modern dhe të digjitalizuar të financave publike.
- Kuptim më të qartë të legjislacionit dhe standardeve të zbatueshme të kontabilitetit e raportimit financiar.
- Njohuri praktike mbi funksionimin dhe ndërlidhjen e sistemeve financiare dhe të prokurimit publik.
- Aftësi për identifikimin e rreziqeve dhe përmirësimin e kontrolleve në proceset financiare.
- Aftësi për rakordimin e të dhënave të personelit, listëpagesave dhe regjistrimeve financiare.
- Njohuri për dokumentimin e proceseve dhe adresimin e rekomandimeve të auditimit.
- Praktika më të mira për transparencën dhe llogaridhënien në administrimin e fondeve publike.

Zhvillimi i temave të trajnimit:

Trajnimi do të mbahet nga z. Nysret Koca, një ekspert i mirënjohur në fushën e menaxhimit të financave publike. Me mbi 20 vite përvojë profesionale në Ministrinë e Financave, z. Koca sjell një bagazh të pasur njohurish dhe praktikash të avancuara në administrimin financiar në sektorin publik.
Ai posedon një numër të konsiderueshëm certifikatash kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat: Planifikim Strategjik; Planifikim dhe Menaxhim Buxhetor; Prokurim Publik; Menaxhim Projektesh; Parashikim i Rrjedhës së Parasë; Raportim Financiar; Menaxhim dhe Kontroll Financiar, etj.

Përvoja dhe ekspertiza e tij do t'i japin këtij trajnimi vlerë të shtuar, me fokus në aplikimin praktik të njohurive në institucionet publike.

Çmimi për pjesëmarrje në trajnim është 599 €.

Në çmim përfshihet: trajnimi, materiali i trajnimit, certifikata, transporti dhe akomodimi në hotel.

Të gjithë të interesuarit duhet që rezervimin e pjesëmarrjes në trajnim ta bëjnë më së largu deri me 12 nëntor **2026**, numri i pjesëmarrësve i kufizuar.

Për informata dhe rezervime kontaktoni:

Tel: 044/100-260,
email: prudencia.consulting@gmail.com